



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	19.06.2018	Dep. DPK	Nr. Prot. 03-03/1708/18
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1613/18	03	Datum 19.06.2018
PËR/ZA/TO:	znj. Jehona KRASNIQI Menaxhere e zyrës së Prokurimit Zyra Kombëtare e Auditimit		
CC:	z. Besnik OSMANI, Auditor i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës		
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Auditimi i pasqyrave financiare vjetore të Komunave për vitin 2018” me nr. të prokurimit 302/18/3958/221 dhe nr. të brendshëm 302/018/006/221.		

E nderuara znj. Krasniqi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Auditimi i pasqyrave financiare vjetore të Komunave për vitin 2018”** me nr. të prokurimit 302/18/3958/221 dhe nr. të brendshëm 302/018/006/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Auditimi i pasqyrave financiare vjetore të Komunave për vitin 2018”** me nr. të prokurimit 302/18/3958/221 dhe nr. të brendshëm 302/018/006/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat

përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyëtimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 11 qershor 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1613/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Auditimi i pasqyrave financiare vjetore të Komunave për vitin 2018”** me nr. të prokurimit 302/18/3958/221 dhe nr. të brendshëm 302/018/006/221, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Zyra Kombëtare e Auditimit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar 30.000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesionale, ma saktësisht në kërkesën nr.2, është kërkuar: *“Minimumi tri referenca ku operatori ekonomik duhet të ketë kryer minimum tri (3) auditime të pasqyrave financiare të institucioneve publike, gjatë tri (3) viteve të fundit, para njoftimit për kontratë”*, ndërsa te dëshmia dokumentare është kërkuar: *“Listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme për shërbime të llojit të ngjashme të lëshuar nga institucionet publike (Ministritë, Institucionet e Pavarura, Komunitet, Ndërmarrjet Publike, BQK dhe/ose Trusti Pensional i Kosovës) me të cilat operatori ekonomik ka pasur marrëdhënie kontraktuale, të realizuara në periudhën e shkruar tre vjeçare para njoftimit për kontratë duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës dhe datën”*, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të LPP-së, si dhe nenin 26.8 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkojë si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket referenca apo certifikata të autoriteteve publike dhe personave privat, e jo siç ka vepruar në rastin konkret autoriteti kontraktues duke cekur vetëm referenca nga institucionet publike (Ministritë, Institucionet e Pavarura, Komunitet, Ndërmarrjet Publike, BQK dhe/ose Trusti Pensional i Kosovës).

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2 parashihet se “Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti

kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencë e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët mund të ofrojnë shërbime të tilla të kënaqshme.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shitesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar të gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !